



Nga kostoja tek çmimet e rregulluara – përcaktimi i çmimeve të rrymës, gasit dhe ngrohjes rajonale në Lituani

nga

prof. Vidmantas Jankauskas

Prezantuar gjatë trajnimit të NARUC/ERRA mbi Rregullimin e Energjisë dhe Përpilimin e Tarifave

5-8 nëntor 2007, Prishtinë, UNMIK/Kosovo

Përmbajtja

- ▶ Parimet e përcaktimit të çmimeve
- ▶ Kërkesat lidhur me të ardhurat
- ▶ Vlerësimi i aseteve dhe kostos
- ▶ Norma e fitimit
- ▶ Shpërbërja
- ▶ Përcaktimi i çmimeve stimuluese
- ▶ Tarifat përfundimtare

Interesat e ndryshëm gjatë përcaktimit të çmimeve

- ▶ Konsumatorët kërkojnë çmime të ulëta dhe cilësi të lartë
- ▶ Kompanitë energjetike kërkojnë të maksimizojnë profitet e tyre
- ▶ Politikanët kërkojnë çmime të ulëta (në veçanti për konsumatorët rezidencialë – votuesit) por gjithashtu dëshirojnë të mbrojnë kompanitë – sponsoruesit e fushatave zgjedhore
- ▶ Rregullatorët kërkojnë drejtësi – baraspeshim të interesave të të gjithëve

Përcaktimi i çmimit është procedurë dyhapëshe

1. Rregullatori përcakton të kushtet e të ardhurave për kompanitë e rregulluara
2. Rregullatori zgjedh strukturën tarifore të cilën ia lejon kompanisë, në mënyrë që të mbledh mjaft të ardhura për të mbuluar koston dhe arritur një fitim të arsyeshëm

ose

Rregullatori merr në shqyrtim strukturën tarifore të propozuar nga kompania – qasje e shfrytëzuar në *Lituani*

Baza normative apo baza e aseteve të rregulluara (RAB)

- ▶ RAB zakonisht nënkupton asetet fikse dhe disa asete tjera që shfrytëzohen gjatë aktiviteteve rregulative
- ▶ Vlera e RAB përcakton koston bruto të kapitalit (amortizimi + profiti operativ)
- ▶ Të ardhurat nga amortizimi duhet të jenë të mjaftueshme për të ndërruar asetet, përndryshe kompania do të shterej
- ▶ Fitimi i lejuar nga kapitali i investuar duhet të nxisë kapitalin për investime të reja

Rregullatori duhet të rishqyrtojë bazën e asetëve të rregulluara

- ▶ Për të bërë një vlerësim të pavarur mbi asetet
- ▶ Kalkuluar vlerën aktuale në bazë të kostove nga e kaluara, të korigjuara përmes shfrytëzimit të faktorëve të indeksimit
- ▶ Nëse çmimi i paguar nga investuesit gjatë privatizimit tejkalon vlerën e asetëve, duhet marrë parasysh vetëm vlerën e duhur të asetëve
- ▶ Nëse asetet janë rivlerësuar pas privatizimit, si duhet t'i trajtojë ato rregullatori? *Shembulli Lituanez*

Çështje tjera të ndërlidhura me përshtatshmërinë e të ardhurave - shpenzimet

- ▶ Kostot operative dhe të mirëmbajtjes
 - ◆ Blerja e të mallrave dhe shërbimeve
 - ◆ Mirëmbajtja
 - ◆ Pagat dhe sigurimi social
 - ◆ Shërbimet (transporti, komunikimi, TI, bankat)
 - ◆ Kostot e inventarit
 - ◆ Të tjera
- ▶ Shpenzime të amortizimit
- ▶ Tatimet (e ndryshme)

Problemet në vlerësimin e kostove

- ▶ Kostot nga e kaluara
 - ◆ Varet nga efikasiteti i kompanisë në të kaluarën
- ▶ Kostot e ardhme
 - ◆ Si kalkulohen parashikimet
- ▶ Vlera e asetëve
- ▶ Vlerësimi i investimeve
 - ◆ Para apo pas investimit

Shembull: kostot pas ristrukturimit

- ▶ Kompania Energjetike e Lituaniisë u ristrukturua në 5 kompani në vitin 2002
- ▶ Kompanitë e reja të rrjetit (transmisioni dhe distribuimi) janë të rregulluara
- ▶ Shfrytëzimi i kostove nga e kaluara ishte realizohej me vështirësi por paraqiste pikë të mirë fillestare
- ▶ U shfrytëzua standardizimi me kompanitë tjera

Funksionalizimi i kostove

- ▶ Prodhimi (rryma, ngrohja)
- ▶ Transmisioni (transportimi i rrymës dhe gasit nga burimi gjenerues tek sistemi shpërndarës përmes shfrytëzimit të linjave të tensionit të lartë apo gypave me shtypje të lartë)
- ▶ Distribuimi (transportimi i rrymës dhe gasit nga sistemi i transmisionit tek konsumatorët finalë)
- ▶ Shërbimet për konsumatorë u sigurojnë konsumatorëve llogaritjen, faturimin dhe inkasimin, shërbime për konsumatorë
- ▶ Shërbimet e transmisionit dhe distribuimit janë tejet intensive nga këndvështrimi kapital dhe përbëjnë një proporcion të madh të kostove fikse, shërbimet e konsumatorëve pothuajse fare nuk varen nga kërkesa

Klasifikimi i kostove

- ▶ Kërkesa apo kostoja e kapacitetit dallon, varësisht nga kërkesa maksimale (ngarkesa maksimale) dhe mund të jetë koincendentale dhe jokoincendentale, $f(\text{kW or m}^3/\text{h})$
- ▶ Kostoja e energjisë në raport me shfrytëzimin e sistemit, $f(\text{kWh, ose m}^3, \text{ose Gcal, ose GJ})$
- ▶ Kostoja e konsumatorëve dallon, varësisht nga numri konsumatorëve që gëzojnë këtë shërbim, $f(\text{Nr i konsumatorëve})$

Funksionalizimi dhe alokimi i kostos në Lituani

- ▶ Në sektorin e energjisë elektrike, kostot ndahen për qëllime funksionaliteti në gjenerim (prodhim), transmision distribuim dhe furnizim
 - ◆ Konsumatorët e lidhur në sistemin shpërndarës (dhe kostot gjegjëse) ndahen sipas nivelit të voltazhit – me tension të mesëm apo të ulët
 - ◆ Konsumatorët me tension të ulët ndahen në rezidencialë dhe komercialë
- ▶ Në sektorin e gasit, kostot ndahen për qëllime funksionaliteti në transmision, distribuim dhe furnizim
 - ◆ Konsumatorët e lidhur në rrjetin shpërndarës ndahen në 5 grupe, varësisht nga niveli i konsumit
 - ◆ Përveç kësaj, konsumatorët ndahen në rezidencialë dhe komercialë

Standardizimi – mjet i dobishëm

- ▶ Nëse keni shumë kompani, ju mund ta shfrytëzoni standardizimin për të vlerësuar kostot e tyre
- ▶ Është me rëndësi që të përcaktohen saktësisht indikatorët krahasues
- ▶ Këta indikatorë mund të jenë punonjësit për konsumatorë, për kWh të shpërndarë apo shitur, prodhuar (rryma, uji, etj) për njësi të prodhimit, etj.

Shembull: standardizimi në ngrohjen rajonale

- ▶ Në Lituani ekzistojnë rreth 60 kompani që rregullohen nga NCC
- ▶ Ato janë të ndara në 5 grupe, varësisht nga prodhimi (ngrohja e shitur)
- ▶ Indikatorët për krahasim janë të përcaktuar
- ▶ Indikatorët teknologjik: humbjet në rrjet, efikasiteti i lëndës djegëse, konsumi i rrymës dhe ujit për kWh të shitur, etj.
- ▶ Efikasiteti operativ: numri i punëtorëve për kWh të shitur, për 1m të gypit, për konsumator, përpjesëtimi i elementeve me kosto fikse ndaj totalit, etj.

Shembull: standardizimi në ngrohjen rajonale (vazhdim)

- ▶ NCC analizon kostot nga e kaluara e kompanive rajonale të ngrohjes
- ▶ NCC standardizon kostot e caktuara
- ▶ Nëse kostot mesatare në grup janë më të ulëta, NCC zakonisht i përfshin në shumën e të ardhurave të nevojshme ato kosto dhe jo ato nga e kaluara
- ▶ Kompania ka të drejtë të sqarojë përse kostot nga e kaluara janë më të larta
- ▶ Nëse kostot nga e kaluara të kompanisë janë më të ulëta, ato përfshihen në shumën e të ardhurave të nevojshme

Mbledhja e të dhënave nga rregullatori

- ▶ Të dhënat nga deklaratat publike nuk mjaftojnë për të përcaktuar çmimet
- ▶ Është me rëndësi që të kuptohen politikat dhe rregullat kontabilare të kompanisë
- ▶ Do duhej miratuar diagrami rregullativ i llogarive
- ▶ Shpeshtësia e raportimit
- ▶ Sigurimi i rregullt dhe standard i të dhënave zvogëlon mundësit për manipulime dhe shton gjasat për saktësi

Dekompozimi i aktiviteteve të ndryshme

- ▶ Qëllimi kryesor i dekompozimit – të përcaktohen çmime të sakta të transmisionit për tregtim me energji elektrike
- ▶ Në sektorët e energjisë elektrike dhe gasit në BE të gjitha aktivitetet kryesore duhet të ndahen nga aspekti ligjor
- ▶ Dekompozimi i aktiviteteve të gjenerimit, transmisionit, distribuimit dhe furnizimit në monopolet vertikalisht të integruara mund të rrisë transparencën në përcaktimin e çmimeve

Dekompozimi në Lituani

- ▶ Në sektorin e energjisë elektrike, NCC filloi me kalkulim ndaras të çmimeve të gjenerimit, transmissionit dhe distribuimit para se të realizonin ristrukturimin – kjo bëri që konsumatori të kuptojë se si formohet çmimi përfundimtar
- ▶ Një qasje e ngjashme është shfrytëzuar në sektorin e gasit – për të kuptuar se deri në çmasë ndikon çmimi i Gazpromit në çmimin përfundimtar
- ▶ Në ngrohjen rajonale, çmimet e gjenerimit dhe transmissionit të ngrohjes kalkuloohen ndaras – për qëllime transparence

Përparësitë dhe mangësitë e rregullimit të normës së fitimit

pro

- ▶ Të ardhurat mbulojnë kostot
- ▶ Profitet janë të pranueshme
- ▶ Shërbime adekuate të furnizimit

Kundër

- ▶ Nuk ka stimulime për zvogëlim të kostove
- ▶ Stimulime të dobëta për efikasitet
- ▶ Rishqyrtim i shpeshtë i kostove

Rregullimi i çmimit maksimal

- ▶ Kostot e parashikueshme parashihen për një periudhë më të gjatë kohore, 3-5 vite
- ▶ Çmimet maksimale kalkuloohen për një periudhë fillestare dhe rishqyrtohen çdo vit, duke shfrytëzuar formulën

$$P_t = P_{t-1}(1 + \text{inflacioni} - \text{efikasiteti})$$

- ▶ Në fund të periudhës rregullative, kostot rishqyrtohen dhe përcaktohen kufij të rinj


Përparësitë e rregullimit të çmimeve maksimale

- ▶ Sigurohen masa të fuqishme stimuluese për zvogëlimin e kostove nga kompanitë
- ▶ Jep stabilitet dhe parashikueshmëri konsumatorëve dhe investuesve
- ▶ Dukshëm zvogëlon barrën rregullative, pasi që kostot vlerësohen vetëm një herë në 3 apo 5 vite
- ▶ Rregullimi i çmimit maksimal shfrytëzohet në Lituani për përcaktimin e çmimeve të energjisë elektrike, gasit dhe ngrohjes rajonale

Cmimet maksimale në sektorin e energjisë elektrike

- ▶ Cmimet maksimale për transmision, distribuim dhe furnizim përcaktohen nga NCC një herë në 3 vjet
- ▶ Zakonisht vlerësimi i asetëve, analiza e kostos, norma e fitimit dhe parimet e përcaktuara janë të aplikueshme
- ▶ Cmimet maksimale përshtaten një herë në vit
- ▶ Në teori çmimet e gjenerimit pëcaktohen nga tregu por për shkak të një prodhuesi predominant çmimet rregullohen
- ▶ Strukturat e tarifave dhe tarifat finale caktohen nga kompanitë e distribuimit, NCC kontrollon nëse ka diskriminimin dhe nëse janë tejkaluar çmimet maksimale

Tarifa e planifikuar mesatare e energjisë elektrike në vitin 2007, RST/VST, ct/kWh



Tarifat rezidenciale për energji elektrike, TVSH e përfshirë, € ct/kWh

| | Tarifa | 2006 | 2007 |
|-----|--------------------------------------|------|------|
| 1.1 | <i>E thjeshtë</i> | 9 | 9.6 |
| 1.2 | - konsumatorët me shporetë elektrikë | 7.8 | 8.4 |
| 1.3 | - që konsumojnë më se 12 MWh/në vit | 7.2 | 7.8 |
| 2 | <i>Koha e shfrytëzimit</i> | | |
| 2.1 | - ditë | 10.4 | 11 |
| 2.2 | - natë, fundjavë | 5.8 | 6.1 |
| 2.3 | - ditë me shporetë elektrikë | 8.7 | 9.3 |
| 2.4 | - natë, vikend me shporetë elektrikë | 4.6 | 5.2 |
| 2.5 | - ditë, konsum mbi 12 MWh/në vit | 8.4 | 9 |
| 2.6 | - natë vikend -"- | 4.3 | 4.9 |

RST tarifat e energjisë elektrike për konsumatorët me tension të mesëm, 2007

| Tarifa | Njësi | Plani I | Plani II | Plani III |
|--|----------|---------|----------|-----------|
| Tarifa me dy komponente | | | | |
| Ngarkesa e kapacitetit | €/kW/m | 0.35 | 0.77 | 1.5 |
| Ngarkesa e energjisë | € ct/kWh | 5.6 | 5.3 | 5.1 |
| Tarifa me kapacitet dykomponentësh, ditë e natë | | | | |
| Ngarkesa e kapacitetit | €/kW/m | 0.35 | 0.77 | 1.5 |
| Energjia ditën | € ct/kWh | 5.9 | 5.6 | 5.4 |
| Energjia Natën | € ct/kWh | 4.2 | 3.9 | 3.6 |
| Tarifa me kapacitet dykomponentësh dhe koha e shfrytëzimit | | | | |
| Ngarkesa e kapacitetit | €/kW/m | 0.35 | 0.77 | 1.5 |
| Ngarkesa minimale | € ct/kWh | 4.2 | 3.9 | 3.6 |
| Ngarkesa mesatare | € ct/kWh | 5.1 | 4.8 | 4.6 |
| Piku | € ct/kWh | 7.6 | 7.3 | 7.1 |
| Fundjave | € ct/kWh | 4.2 | 3.9 | 3.6 |

Cmimet maksimale në sektorin e gasit në Lituani

- ▶ Çmimet maksimale për periudhë 5-vjeçare caktohen nga NCC për transmision, distribucion dhe furnizim
- ▶ Për kalkulimin e parë të gjitha kostot rishqyrtohen, asetet vlerësohen dhe përcaktohet norma e fitimit
- ▶ Kompania lituaneze e gasit sajon strukturën finale dhe NCC e miraton atë
- ▶ Çmimet përshtaten çdo vit, duke marrë parasysh inflacionin, lëkundjet në volumin e gasit të transportuar, ndryshimet tatimore dhe efikasitetin e paracaktuar nga NCC
- ▶ Nëse profiti tejkalon limitet e caktuara, zbatohet mekanizmi i ndarjes së profitit

Tarifat e gasit natyral në vitin 2007

► Rezidencialë, me TVSH

| | Fiks, €/muaj | Variabël , €/m ³ |
|-----------------------------|-----------------|-----------------------------------|
| <90 m ³ | - | 0.36 |
| 90-800 m ³ | 0.6 | 0.26 |
| 800-20000 m ³ | 3.5 | 0.19 |

V.Jankauskas, ERRA

► Konsumatorët komercialë paguajnë

- ◆ Pagesën fikse (furnizimin)
- ◆ Pagesën për kërkesë (kërkesa maksimale gjatë pikut, në m³/h)
- ◆ Pagesën për energji, €/m³

- ◆ Konsumatorët janë të ndarë në disa grupe

Çmimet maksimale në ngrohjen rajonale

- ▶ Çmimet maksimale për ngrohje rajonale caktohen për periudha 3-5 vjeçare, analizohen të gjitha kostot, shfrytëzohet standardizimi, rishqyrtohet vlera e asetëve, përcaktohet Norma e Fitimit
- ▶ Çmimet përshtaten me anë të formulës që vlerëson jo vetëm inflacionin por edhe ndryshimet në çmimet e lëndës djegëse, ditët e shkallëzimeve, tatimet

Cmimet e ngrohjes rajonale në Klaipeda

| Tarifa e prodhimit të ngrohjes | | |
|--------------------------------------|----------------------------|----------|
| E thjeshtë | | 21 €/MWh |
| Dy-komponente | 4.3 €/kW/muaj | 15 €/MWh |
| Tarifa e transmissioinit të ngrohjes | | |
| E thjeshtë | 11 €/MWh ose 7.7 €/kW/muaj | |
| Prodhimi dhe transmissioini | | |
| E thjeshtë | | 29 €/MWh |
| Dy-komponente | 7.7 €/kW/muaj | 19 €/MWh |
| Ngarkesa e konsumatorit | | |
| 1 €/muaj | | |

Ju falemnderit p r v mendje!